


Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 19 (paragrafi 11) të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit (nr.01/2014), Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 27.11.2014, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-3972-14 për z.Jusuf Kryeziu – Udhëheqës i Auditimit në Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm, për shkak se është shmangur dhe parandaluar situata e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-3972-14, për Zyrtarin e lartë, z.Jusuf Kryeziu – Udhëheqës në Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z.Kryeziu fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, pas të cilës ai është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur dhe për të parandaluar kështu situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Kryeziu është deklaruar se shumë shpejt do t'i bëjë këto ndryshime, edhe pse ai ka menduar se ato janë të kryera.

Ndërkohë, z.Kryeziu, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjellë një shkresë zyrtare (DPK/DPKI-03-4391/14) bashkë me "Informata mbi biznesin" nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) në të cilën shihet se Jusuf Kryeziu ka heq dore nga te qenurit person i zutorizuar i biznesit privat N.T.T."Argjendi".

Tani, z.Kryeziu, ushtron vetëm funksionin e tij publik; Udhëheqës i Auditimit në Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm në Prishtinë.

II. Në mbështetje të nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtore Agjencisë kundër Korrupsionit
Hasan Preteni

